



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.04.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiçi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiçi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiçi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal, Haki Jashari, drejtor i QKMF-së, përf. e KFOR-it dhe Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete
Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiçi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i shpenzimeve Janar-Mars 2022
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i Draft Rregullores nr.-I-36, të dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit
6. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja - Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se kemi një ndryshim të anëtarët e Kuvendit, kryesisht të lista serbe dhe me këtë rast ftoj znj.Biljana Spasic, të japë betimin për anëtare të Kuvendit komunal.

Biljana Spasic, duke përsëritur tekstin pas kryesueses dha betimin solemn për anëtare të Kuvendit komunal.

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 17 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për 4 vota kundër dhe 3 vota abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Parqet kërkesën nga DEFZH-ja, për raportin e shpenzimeve për periudhën janar-mars 2022, për kategoritë ekonomike paga dhe medijtje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale.

Sami Ahmeti – Unë e di se ky raport nuk votohet, por edhe si i tillë duket të jetë shumë i varfër. Siç duket po ka mungesë vullneti në raport që raportet të bëhen të specifikuara shpenzimet veç e veç. Ky e ka emrin raport i shpenzimeve, por në të na janë ofruar vetëm si psh zyra e Kryetarit ka shpenzuar 1,958.20 €, nga 10,000 €, sa ishin të parapara. Mirëpo, nuk figuron për çka janë shpenzuar ato a për material administrativ, apo për pije alkolike, apo për diçka tjetër. Kështu, vazhdohet në këtë raport dhe ju keni mundur të na sjellini vetëm shifrën sa janë harxhuar deri më tani. Pra, ka edhe më keq, por unë besoj se një raport më i detajuar do ta ngriste edhe nivelin tuaj sepse transparenca nuk i bën askujt keq, përveç atyre që dëshirojnë ti keqpërdorin.

Xhelal Krasniqi – Ne e pamë raportin dhe nuk dua ti përsërisë ato që i tha z.Sami, por unë po e shohë se nuk është respektuar standardi i njëjti psh te pagat dhe medijtjet është shpenzue 100 % e buxhetit, ndërsa te shpenzimet komunale 19.16, te subvencionet dhe transferet 61.75. Pyetja është se a është në pyetje me u respektue i njëjti standard nëse, janë shpenzue 100 % për paga dhe medijtje, atëherë 10 %, a është në pyetje 90 %, a është suficit, apo është shpenzim i 3 mujorit. E dyta, e përmendi z.Sami, te shpenzimet tjera, por te subvencionet dhe transferet 61.75 % për këtë 3 mujor, a është fjala nga shuma e planifikuar buxhetore, apo është fjala vetëm për 3 mujorin e shpenzueshëm 61.75 %.

Ajet Berisha – Fillimisht është shqetësuese raportimi aq joserioz dhe kjo ka të bëjë se totalisht drejtoresha e nënvlerëson raportin para anëtarëve të Kuvendit komunal, do të thotë është një nënvlerësim absolut. Mirë e tha z.Sami, ka mund me thënë se nga planifikimi i buxhetit, që është mbi 11 milionë, janë shpenzue 2 milionë edhe u krye që i bjen Ekzekutivi me i thonë Kuvendit, se ne i qojmë ku të duam. Nuk ka kontest në aspektin e shpenzimeve të pagave dhe medijtjeve sepse ajo është e planifikuar dhe kanë shkue qind për qind, që mund ta nënkuptoj atë që e tha z.Xhelal, se është planifikim i 3 mujorit 1 milion e 24,000, qind për qind janë shpenzue për 3 muaj. Sa i përket shpenzimeve tjera, nuk përdoret standard i njëjtë. Në bazë të buxhetit të miratuar për subvencione janë 850,000 €, ndërsa këtu thotë 61.75 %, janë shpenzue. Subvencione këtu, paraqiten 482,000, do të thotë nuk është standardi që është përdorë në paga dhe medijtje. Aspekt tjetër shumë me rëndësi është mungesa e transparencës në raportim të shpenzimeve, janë shpenzue 297,642.65 subvencione dhe absolut nuk merrë mundin askush me tregue se ku këto mjete janë shkue, kujt iu kanë dhënë këto. Anëtarët e Kuvendit komunal, kanë interes me pa se në cilin drejtim kanë shkue këto subvencione, kush ka përfitue nga këto, që pastaj me përcjellë mënyrën e subvencionimit se a është shkue sipas Rregullores. Mirëpo, drejtoresha nuk merrë mundin, e jepë një shifër aty e thotë në Arsim 180,000, Kryetari kaq etj. Edhe më shqetësuese se kaq, megjithatë nuk ma merrë mendja se ka më shqetësuese se mungesa e transparencës, por është shpenzimi i mjeteve te kategoria e investimeve kapitale. Merre me mend për 3 mujorin e parë 0.5 % keni shpenzue në investime kapitale dhe ju pretendoni me shpenzue buxhetin e vitit 2022, që është dikund mbi 4 milionë. Do të thotë 23,000 €, keni arritë me i shpenzue deri tash për 3 muaj, që edhe këto sigurisht se keni pasë ndonjë borxh se nuk ma merrë mendja se është krye ndonjë punë, as që keni fillue. Mirëpo, nuk ju bëhet vonë edhe me ju teprue mjete, kështu që për juve është krejtësisht normale, e për drejtoreshën ky lloj raportimi shpresoj që ti vie keq nga anëtarët e Kuvendit, me këtë mungesë të transparencës.

Zarifë Behluli – Ne ua kemi dorëzue raportin e shpenzimeve janar-mars 2022 dhe të gjithë ju që e merrni fjalën pavarësisht a lavdëroni, apo akuzoni, unë ju falenderoj. Për mua të gjithë jeni një dhe të gjithë për mua jeni apartiakë. Unë për qe e udhëheqi DEFZH-në, aspak nuk e kam punën që e bëjë politike sepse politikisht ne dihet kur luftojmë, ndërsa pa politikë punojmë në mandatin 4 vjeçar. Raporti është i mangët,

detajet e shpenzimeve dhe unë do të ua sjellë shpenzimet një nga një. E kryva me vërejtjen e parë. Paga pse 100 %, alokimi 3 mujor i shpenzimeve janar-mars, pagat i kryen Ministria e financave dhe nuk i kryejmë ne, aq sa ka nevojë i alokon dhe i shpenzon dhe ajo është vlera e pagave. Subvencionet, e njejta gjë vlen për vërejtjen e tretë që e dha zotëriu dhe subvencionet aq sa kemi pasë mundësi i kemi aloku dhe i kemi shpenzue aty ku ka pasë nevojë. Tash, nëse don me ditë ku janë shpenzue infrastruktura rrugore 110,022 €, të gjitha për covid janë shpenzue. Alokimi 94,250 janë të gjitha për covid të shpenzuara. Drejtoria e shëndetësisë, të gjitha mjetet për lehona janë shpenzue, eventualisht ndonjë rast i sëmundjeve. Bujqësia e ka pasë një fakturë obligim të vitit 2021, 9,498.65, është shpenzue. Drejtoria e Arsimit të gjitha për bursa, nxënësve, udhëtime kanë shkue mjetet, ndërsa tash presim miratimin e vendimit të bartjes për me i krye studentët. Pastaj, 482,022 janë të mbushura me të hyra vetanake, përveç pjesës së grandit që e kemi edhe 297,642.65 janë shpenzue. Do të thotë në 3 mujorin e parë kemi arritë në bazë të alokimit 61,75 % me i shpenzue. Ndërsa, te investimet kapitale ju shumë mirë e dini se me investime kapitale nuk punohet as janari, as shkurti, as marsi, vetëm me 15 mars fillojnë që kanë të drejtë me punue. Këto, 23,261, kanë mbetë obligimi i rregullimit të kanalizimit në Obiliq, 12,686.59, që është bërë shpenzim në këtë vit dhe asfaltimi i rrugëve rurale 10,575, që ka qenë obligim i vitit 2021. Pasi ka pasë buxhet te grandit qeveritar në fillim të vitit ne e kemi krye obligimin, ndërsa te bartja e mjeteve që ua kam sjellë juve, aty ku nuk ka pasë buxhet i kemi vendosë mjetet për me i mbulue shpenzimet e vitit të kaluar.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Abdyrrahman Krasniqi – Duke pasë parasysh se në vitin e kaluar është ndarë buxheti dhe kemi synuar të bëjmë subvencionimin e energjisë elektrike në Komunën e Obiliqit sipas Ligjit për Obiliqin, i cili siguron një kuotë më të ulët për qytetarët e Obiliqit, ne e kemi hartue një Rregullore e cila nuk është në pajtueshmëri me MAPL-në. Mirëpo, në këtë vit jemi kthyer prapë duke pasë parasysh se kemi kërkesa nga qytetarët, duke pasë parasysh se Qeveria dhe ZRRE-ja, nuk janë duke e implementue një pjesë të Ligjit për Obiliqin, ne i kemi bërë disa plotësim ndryshime të Rregullores, të cilat edhe ua kemi dërguar juve. Ndryshimet janë te neni 5, e kemi shtuar pikën 4 që Komuna e Obiliqit kërkon nga ZRRE-ja, një zgjidhje alternativë në implementimin e këtyre mjeteve njëkohësisht të mbështesë në subvencionimin e energjisë elektrike deri në implementimin e kuotës më të ulët sipas Ligjit për Obiliqin, i cili është funksional, por nuk është duke u marrë parasysh nga ZRRE. Ne e dimë se këso lloj praktikash ZRRE-ja, ka përdorë në vitin e kaluar dhe Qeveria e ka mbështetë, praktika që janë për serbët e Mitrovicës së veriut. Ne për këtë arsye po insistojmë me çdo kusht që ajo alternativë të përdoret edhe te ne. Po ashtu, kemi edhe një plotësim ndryshim te neni 7 te lista e konsumatorëve të cilët subvencionohen dhe Komuna, në bashkëpunim me KEDS-in dhe KESK-on përpilon listën e konsumatorëve të amvisnisë e cila do të subvencionohet nga Komuna. Këtë e kemi krye dhe këtu e kemi përfshi edhe ZRRE-në, deri në implementimin e kuotës më të ulët sipas Ligjit të Obiliqit, i cili është referencë për neve dhe nuk do të ndalemi deri në momentin që ZRRE-ja, të ketë parasysh këtë ligj. Po ashtu, edhe te pika 2 Komuna prapë kërkon që ZRRE-ja të respektoj Ligjin e Obiliqit dhe deri në momentin që të respektohet Ligji i Obiliqit të mbështesë subvencionimin e energjisë elektrike bashkë me Komunën që e ka ndarë buxhetin në vlerën dikund rreth 300,000 €. Te neni 8, e kemi një ndryshim se e kemi shtuar ZRRE-në sepse është përgjegjëse dhe duhet këtë me implementue. Te neni 9, e kemi shtue një pikë shtesë që ZRRE-ja duhet të mbështesë Komunën për kuotën më të ulët derisa plotësisht të implementohet Ligji për Obiliqin.

Sami Ahmeti – Secili nga qytetarët i gëzohet mundësisë eventuale për lirimin e tarifave të rrymës elektrike, e cila nuk do të duhej të jetë vetëm te rryma, por edhe te fushat tjera, si është tatimi në pronë, te pagesa e ujit e tjera, sepse ne jemi të veçantë për shkak të rrethanave dhe dëmeve që shkakton KEK-u, ky aset ndaj banorëve të Obiliqit, shëndetit, të pronës dhe ambientit të tyre. Këtë gjë e kemi të vërtetuar edhe me ligj të veçantë, për të cilin shfrytëzoj rastin ti falenderoj hartuesit e tij, pra kolegët nga LB-ja. Kur jemi te kjo Draft Rregullore për subvencionimin e energjisë elektrike, do të doja që të informohem nga Ekzekutivi se a është

bërë ndonjë takim paraprak me Ministrinë gjegjëse, cilat janë ndryshimet nga Rregulloret që pak a shumë i ceku drejtori dhe a do të bie përsëri në kundërshtim me rregullat ligjore sikurse që është ra në dokumentin paraprak të vitit 2019. Pastaj, a e dini se kjo Draft Rregullore bie ndesh me Ligjin për Obiliqin, respektivisht nenin 8, paragrafin 2, pika 2.1 dhe 2.2, ku thotë se Qeveria në bashkëpunim me ZRRE-në siguron një kuotë më të lirë dhe furnizim të rregullt të energjisë elektrike. Pra, nuk thotë që Komuna, apo Kuvendi komunal por Qeveria në bashkëpunim me ZRRE-në. Ne mendojmë se edhe ky tentim është prapë i menduar paushall dhe do të rezultoj i kotë. Edhe shkresa e MAPL-së, respektivisht e Ministrisë së zhvillimit ekonomik e dt.25.10.2019, ku kërkoi shfuqizimin e Rregullores së parë të këtij Kuvendi, thotë se nuk është kompetencë e Kuvendit që të nxjerrë Rregullore të tilla, të paktën jo sipas ligjeve në fuqi, e as sipas Ligjit të Obiliqit. Në nenin 3, të Draft Rregullores së shtatorit 2019, ishte paraparë ashtu siq ceket edhe në Ligjin për Obiliqin, që Qeveria të ndan një fond për subvencionimin e rrymës. Shumica e neneve tjera vazhdojnë të jenë të njejta edhe në këtë Rregullore të re, por këtu kemi paraparë që mjetet e subvencionimit të rrymës ti merrni nga mjetet e ndara nga tani, qka po bie përsëri ndesh me Ligjin për Obiliqin, neni 9, pika 1.1, që specifikon destinimin e këtyre mjeteve që janë në investime për zhvillimin e komunitetit në arsim, shëndetësi, mbrojtje të mjedisit dhe infrastrukturë. Pasi që jeni marrë me këtë punë, a ka ndonjë informatë për numrin e familjeve, apo të njehsorëve elektrikë në Komunën tonë dhe sa janë shpenzimet vjetore në Komunën tonë, në mënyrë që edhe ne të mund të japim kontributin tonë në vendin e duhur sepse në Kuvend, unë nuk besoj se mund ta marrim këtë vendim. Për punën e kuotës më të lirë të rrymës elektrike është angazhuar edhe deputeti Halil Thaqi dhe është në bisedime me grupin më të madh parlamentar me Qeverinë e Kosovës dhe shumë shpejtë pritet të ketë edhe një rezultat. Duke pasur për bazë këto që i thamë më lartë dhe faktet se nuk po duket që kemi ndonjë miratim paraprak nga Ministrinë, ne nuk do të votojmë kot dhe mendoj që kjo qka po bëjmë sot është e kotë.

Kryesuesja – Kjo Rregullore ka pasë një debat publik dhe ndoshta kishte me qenë më mirë sikur të kishit marrë pjesë dhe të gjitha këto ti konsultoni me Komisionet dhe me Drejtorinë.

Ajet Berisha – Fillimisht kjo bie ndesh me Ligjin për Obiliqin, neni 8 dhe 9 i cili përcakton këto të drejta dhe këto benefite nga vijnë. Mua, më vjen keq që Kryetari i Komunës minimalisht 2, ose 3 herë brenda këtij viti është takuar pikërisht me ministrin që është përgjegjës për nxjerrjen e një Rregulloreje të tillë dhe është përgjegjës bashkë me Kryetarin e Komunës, që të takohet me ZRRE-në dhe ZRRE-ja të marrë vendim për kuotë më të ulët. Mjetet të cilat do të mbuloheshin nga Qeveria, jo nga mjetet e tani do të thotë me z.Liburn, e kam parë 2,3 herë, duke u fotografuar dhe nuk e di se çfarë kanë bërë. Është shumë me interes për qytetarët, që këtë punë me vazhdu në mënyrë ligjore dhe me krye kompetentët që është Qeveria me ZRRE-në. Pra, kjo Rregullore bie ndesh me Ligjin e Obiliqit në 2 pika, me nenin 8 dhe 9 dhe nuk është se unë s'kam dëshirë, por është krejtësisht e kotë dhe kuptohet nga këto se këtë Rregullore prapë do ta kthejnë si në herën e kaluar sepse nuk është në harmoni me ligjet në funksion. E dyta, në rast se është e kundërta drejtori në fjalë është dashur me Ministrinë, apo me MAPL-në, me u konsultue prapë për nenet që kanë qenë problematike. Po ashtu, a ka mundësi Komuna me i subvencionue shpenzimet e energjisë elektrike, do të thotë me na tregue sot që po në proporcion me kërkesat dhe ndryshimet që i kemi bërë ne se jemi kordinue me MAPL-në dhe kjo Rregullore ka me ardhë e ligjshme dhe ne kemi me mund me bë një punë të tillë. Përndryshe, krejtë kjo që ne po e bëjmë është me humbë energji dhe fillimisht më vjen keq ai Komision që ka punue sepse në fund Ministria e kthen si të paligjshme. Ne para se me sjellë në Kuvend kemi mund me u interesue në Ministri dhe me pa se a është e ligjshme, a është në harmoni me ligjin, e jo pasi te votojmë me na ktheje prapë. E dyta, drejtori është dashur me marrë mundin me ditë minimalisht sa shpenzon Komuna e Obiliqit, brenda vitit dhe sa është kjo përqindje sepse mund të ndikoj nesër negativisht në vendimin e ZRRE-së, në rast se e marrim psh se brenda vitit Komuna e Obiliqit shpenzon 10 milionë energji, që unë nuk e di sa shpenzon dhe me i dhënë ne 300,000 €, kishte me qenë një sinjal i keq te ZRRE-ja, që i bie 3 %. Në të ardhmen një vendim i ZRRE-së, kishte me dëmtue kjo shumë e jona e ndarë sepse kishin me arsyetu se vetë Komuna e Obiliqit ka hartue një Rregullore të tillë, që ka dashtë me subvencionue 300,000 €, ose 3 % është jashtë zakonisht pak. Prandaj duke i pasë për bazë këto, kishte me qenë mirë që drejtori

paraprakisht me na tregue se sa janë gjasat me kalue Rregullorja, në të kundërtën pa këto informata ne nuk do të marrim pjesë në votim.

Shaip Paloja – Vërtetë, mua më habit fakti qysh dikush është kundër një subvencioni për qytetarin e Obiliqit, jo për mua por për Obiliqin. Duhet me falenderu për iniciimin LB-në që e ka bërë në Kuvend, por subjekti i LVV-së atë ditë kur është votuar Ligji për Obiliqin, ne e dijmë të gjithë se e ka kallë edhe Prishtinën, edhe Kuvendin e Kosovës. LB-ja, ka qenë nëse nuk gaboj në listë me PDK-në. Nëse, dikend duhet me falenderu atëherë është LDK-ja dhe PDK-ja, pse ka kalue Ligji për Obiliqin. Këtu, u thanë disa të pavërteta sepse në Rregullore ekziston një nen që thotë se një marrëveshje do të hartohet në mes të Kryetarit dhe kompanive përgjegjëse për çmimet që do të jenë. Ajo marrëveshje do të kaloj përmes Kuvendit komunal, që do të thotë se nëse ne sot e miratojmë këtë Rregullore, pastaj do të vjen në shprehje edhe një marrëveshje në mes ZRRE-së, KEDS-it, KESCO-së, dhe të gjitha atyre kompanive që janë përgjegjëse. Besoni, më vjen keq qysh dikush thotë nuk e votoj një subvencionim për energji elektrike për këtë qytetarë. Edhe kjo hyn në mbrojtjen e mjedisit dhe shumë gjërave tjera, që ne sot jemi të prekur.

Abdyrrahman Krasniqi – Dua ti përgjegjem z.Sami dhe z.Ajet se Ligji për Obiliqin, nuk e ndalon subvencionimin e energjisë elektrike për qytetarët, por fatkeqësisht Ligji për Obiliqin, nuk është duke u implementuar tani. Ne e përkrahim çdo iniciativë, çdokush që punon në këtë drejtim, që ky ligj të implementohet sa më shpejtë. Dallimi në mes të Rregullores së kaluar dhe Rregullores së tanishme është se më heret iu ka drejtue Qeverisë, ndërsa tash sipas informatave e takimeve duhet të iu drejtohem ZRRE-së dhe këtë ndryshim plotësim e kemi bërë. Rregullorja ka qenë një muaj ditë në debat publik me qytetarë, me partitë dhe me oponentët që po kritikojnë tash. Sa i përket kategorisë së subvencioneve, do të thotë e lejon në këtë mënyrë dhe ne jemi për me zbutë deri në momentin që ZRRE-ja dhe Qeveria të fillojnë implementimin për kuotën më të lirë. Sa i përket asaj se sa njehsor i kemi në Komunën e Obiliqit dhe sa kemi shpenzime, këtë statistikë ne e kemi nxjerrë në vitin 2020, dikund afërsisht i kemi 5,000 njehsor, por ky numër mund të rritet, apo të zvoglohet. Për këtë arsye ne nuk kemi cekë vlerë të caktuar sa kemi me mbështetë qytetarin, por ne jemi të interesuar me subvencionu qytetarin deri në momentin që fillon implementimi i Ligjit për Obiliqin. Këtë e kemi kërkuar dhe e kërkojmë nga Qeveria si dhe kërkojmë mbështetjen e deputetëve për qytetarët e Komunës tonë.

Ajet Berisha – Z.Shaip sa për sqarim neni 8 e përcakton saktë këtë punë masat shtesë për përmirësimin e jetës së banorëve në zonën e veqantë. Nën 1, thotë Qeveria në bashkëpunim me Komunën krijon lehtësira të vazhdueshme për banorët e zonës së veqantë. Pika 2, Qeveria në bashkëpunim me ZRRE-në siguron, do të thotë është përgjegjësi e Qeverisë një kuotë më të ulët të energjisë elektrike dhe furnizim të rregullt me energji elektrike për banorët e zonës. Kjo, do të thotë se nuk është në kompetencën e Kryetarit të Komunës, në bazë të Ligjit për Obiliqin, të merret vesh me ZRRE-në. Do të thotë këtë punë e bën Qeveria dhe kjo është taksativisht në nenin 8, pika 2.1 dhe 2.2 e përcakton saktë këtë çështje se kush duhet të merret vesh për kuotën më të ulët të energjisë elektrike për zonën e rrezikuar. Drejtor, nuk është e vërtetë se ne nuk po dëshirojmë, por fillimisht ku i merrni këto mjete. Në rast se pretendoni që këto mjete me i marrë nga mjetet e taniemës edhe neni 9 e përcakton saktë ku kanë të drejtë mjetet e taniemës me u shpenzue, e këto janë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, në infrastrukturë, sport, shëndetësi dhe në arsim. Pra, ligji e përcakton saktë se ku shpenzohen mjetet e taniemës. E dyta është edhe humbje e energjisë edhe në rast se 300,000 euro do të subvencionojmë të jeni të bindur qytetarët as që kanë me ndje këtë sepse më të rëndësishmen drejtor nuk e the nëse, e keni numrin e njehsorëve, a e din përafërsisht sa shpenzon Komuna e Obiliqit brenda vitit. Pastaj, 3% në subvencionim në secilën fakturë besoni, shumë pak vërehet prej qytetarëve dhe nuk ka me ndikue, por si humbje e energjisë dhe si shembull çfarë po i japim ZRRE-së sepse ky subvencionim nesër ka me qu te një vendim i ZRRE-së, që ka me thënë se 3 % ne e ulim kuotën e energjisë për Komunën e Obiliqit, që fatkeqësisht është shumë pak. Kjo, kur është nisë fillimisht është menduar 25 % ulja e kuotës së energjisë për zonën e rrezikuar. Po ashtu, në fund kur mendojmë se Ministria ka me kthy vendimin si të paligjshëm, atëherë pse po harxhojmë energji.

Samire Berisha – Unë e kam vetëm një pyetje a përfitojnë të gjithë qytetarët e Obiliqit, nga kjo Draft Rregullore për energji elektrike.

Sami Ahmeti – Me cekë që dikush nuk e dëshiron subvencionimin ose ndihmën e qytetarëve në këtë Kuvend nuk besoj, madje as ata që janë partnerë të juaj të kualicionit, nuk besoj që nuk e dëshirojnë një ndihmë të tillë. Ne jemi për me i subvencionue, me i ndihmue dhe me i shtye qytetarët që me ua lehtësue jetën. Megjithatë, ne e cekëm dhe nuk është se nuk dëshirojmë, por është se bjen në ndesh, nuk po tregohet diçka që është bërë ndryshim në raport me Draft Rregulloren paraprake të vitit 2019, që na siguron se kësaj radhe do të funksionoj. E tha edhe drejtori se në Rregulloren e parë i kemi bërë kërkesë kryesisë, ndërsa tash duhet me i bë kërkesë ZRRE-së, është e paqëndrueshme. Sa i përket asaj se kush ka qenë në atë kohë në Kuvend, kush ka votue deshta me i tregue parafolësit se edhe subjekti që deri dje keni flertue me të ka qenë bashkë me VV-në në ditën kur është votue Ligji për Obiliqin.

Enver Gashi – Unë deshta me ua sqarue çështjen e 300,000 €, dhe kush përfiton. Është e specifikuar në Draft Rregullore se të gjithë konsumatorët e amvisnisë përfitojnë nga shuma prej 300,000 €. Për shumën prej 300,000 €, dikush po thotë 3 % është llogaritë kjo se unë kam punuar në Rregulloren e vitit 2019 dhe dikund afër 500 me kuotën e atëhershmit të konsumatorëve 500 kwh për konsumatorë, që i bie shpenzimi normal mesatar prej 600 është 700, që faktikisht i bjen mbi 50 %. Unë po flas gjithnjë për familjet prej 4-5 anëtarëve, që është llogaritë kjo dhe është 500 kwh. Mundësia është me ndryshue, por jo shumë, mund të bie në 400 dhe më shumë nuk bie.

Ajet Berisha – Kolegë Enver, mendoj se në bazë të raporteve shpeshherë që i kam lexue dikund 160 milionë, 170 milionë brenda vitit KEK-u, tash KESCO merrë për renergji që paguajnë qytetarët gjithë në tërë Kosovën. Në rast se Komuna e Obiliqit në shumicën e aktiviteteve përfaqëson Kosovën 1 %, edhe me territor, edhe me shpenzime, edhe me buxhet, me të gjitha, do të thotë dikund delë që Komuna e Obiliqit i harxhon 16 -17 milionë brenda vitit.

Enver Gashi – Më fal që po ndërhyj, por përqindjen llogarite më mirë se 170 nuk i bjen 17, sepse 17 është 10 %.

Ajet Berisha – Nëse, është kështu si shumë, atëherë ke të drejtë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për e aprovuan Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Draft Rregullores nr.-I-36, të dt.25.02.2019 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit

Sami Ahmeti – Ne nuk duhet të bëjmë Rregullore strikte për biznese, që aq shumë kanë pësuar nga pandemia dhe kriza ekonomike nën 1, duke pasë parasysh dëmet që iu kanë shkaktuar nga pandemia dhe nën 2, Komuna e Obiliqit është shumë afër Prishtinës edhe kështu këto subjekte nuk kanë profit të mjaftueshëm për shkak të këtyre faktorëve. Në Rregulloret e tilla, do të duhej të futeshin edhe institucionet publike psh Komuna, zyra pritëse si dhe zyra për dokumente civile, që të punojnë me pauza të kordinuara, e jo të mbyllen psh nga ora 12-13, të gjitha këto institucionet e qytetarëve nevojtarë shumica e të cilëve, kanë orë pauze në atë kohë sillen vërdallë. Pra, të gjendet mundësia e kordinimit të pazave, që këto zyre të iu shërbejnë qytetarëve, gjatë gjithë orarit të punës. Si grup i LVV-së, mendojmë se kjo Rregullore ka më shumë për qëllim denimet e bizneseve, se sa të rregulloj diçka sepse nuk mund ti kërkohet një biznesi i cili nuk ka profit të filloj punën në ora 8 psh në butik, e nëse nuk fillon në ora 8, të denohet, ose të punohet deri në ora 21, që dihet se në Obiliq pas orës 19, kanë punë vetëm marketet e mëdha, barnatoret si dhe kafiteritë, kështu që ne jemi kundër kësaj Rregulloreje.

Xhelal Krasniqi – Rregullorja e cila na është prezentue neve, kisha pasë një kërkesë, një lutje për shkak që qytetarët tonë e shohin sepse është copy-paste e ndonjë Rregulloreje tjetër, ose nga ndonjë Komunë tjetër dhe nuk i është përshtatë Komunës tonë. Vetëm një rast po e marrë që z.Sami i përmendi disa raste, por atë që nuk e përmendi është se këtu, thotë ditën e dielë dyqanet zejtare nuk do të punojnë përveç gjelltove,

qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktareve, autolarjeve dhe pikave të shitjes së shtypit ditor. Mendoj se ne nuk duhet të dalim skandaloz, nuk duhet ta ulim autoritetin ose dinjitetin e Kuvendit, por të përshtatet Rregullorja, ose ti modifikohet specifikave të Komunës tonë.

Ajet Berisha – Në këtë Rregullore mendoj se disa gjëra duhet të hiqen, e disa të rregullhen. Neni 8, ndërmarrjet prodhuese dhe ndërtimore, depot tjera, orari i punës në depo të artikujve ushqimor, depotë e materialit ndërtimor, ndërmarrjet që merren me prodhim e betonit si dhe ndërmarrjet tjera prodhuese, do të jetë verës prej 7-18. Pavarësisht se duhet të zbatohet edhe Ligji i punës, që në këtë drejtim i delë punë edhe Drejtorisë së inspeksionit dhe pikërisht kjo Drejtori është më së shumti përgjegjëse për këtë punë, unë mendoj se orari i punës për këto duhet të zgjatet, jo me qenë prej 7-18. Nëse, unë jam duke ndërtuar shtëpi dhe punëtori i ndërmarrjes së ndërtimit (a është e regjistruar ajo ndërmarrje apo jo) punon deri në ora 8, a do të vjen inspeksioni me gjobit. Pra, është shumë me interes me i parapa disa elemente që mos me na ndodhë se me nxjerrë punë koti, ose me nxjerrë probleme pse duhet me përfundue punën në ora 18 verës punëtorët e ndërtimit. Gjithashtu, të dielën thotë mos me punue dhe festave depotë, që është edhe materiali ndërtimor mendoj se ne duhet me u praktikue dhe bazue nga jeta jonë, që këto depo ndërtimore të shtuneve dhe të dieleve zakonisht kanë interes për ne me qenë hapur sepse ne punojmë në atë kohë. Mendoj se depot e materialit ndërtimor duhet të hiqen nga kjo ndalesë. Element tjetër me rëndësi në këtë drejtim është neni 10, thotë veprimtaria e kafe bareve, diskoklubeve, internet kafeve, fitnesit, orari i punës në kafe bare dhe disko klube është i njejtë për 2 sezonet fillon në ora 7 dhe mbaron në ora 24. E njejtja që nuk ndryshon është neni 2, do të thotë orari i punës në kafe bare dhe në disko klube është i njejtë për 2 sezonet fillon në orën 7 dhe mbaron në orën 23. Tash, drejtor cili qëndron neni 1, apo 2 sepse kështu po krijohet një konfuzion, njëri nen duhet të hiqet se po e thotë të njejtën gjë në rast se nuk ke mendue diçka tjetër, apo është gabim teknik. Pastaj, neni 4, thotë orari i punës për internet kafe dhe bastore, kazino, lojëra të fatit dhe fitnes fillon në ora 8 dhe mbaron në ora 23. Ju lutem Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka nxjerrë një ligj që i ka ndalue lojërat e fatit, prandaj largoni këto. Është absurde me na shkue neve kjo në shqyrtim ligjor që me pa se ende po merremi me veprimtari që nuk ekzistojnë, të ndaluara me ligj. Pra, këtu duhet me përmirësue dhe me i heqë ato, që nuk ekzistojnë. Nen tjetër që është dashtë me u shqyrtue dhe me u saktësue ndoshta, është neni 15, pika 3 baret, kafenetë si pjesë përbërëse e pikave të shitjes së karburanteve funksionojnë sipas nenit 9, paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje. Neni 9 paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje thotë tek hotelet dhe motelet mund të punojnë pandërprerë vetëm me shërbim recepcioni, bujtina, fjetje, por duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera, që kjo nuk lidhet absolut me nenin bazë sepse pika 2 ka të bëjë me bujtina e fjetje, ndërsa shërbimet në hotele e restorante pas orës 24 ndalohen. Duhet me nxjerrë një nen të veçantë se këtu fjala është ndoshta, për shitjen që po bëhet brenda pikave të karburantit dhe për shërbim me kafe, që edhe këtë duhet me ndalë sipas kësaj Rregulloreje. Neni 16, orari i punës në barnatore, ordianca dhe klinika private që mendoj se këtu z.Fidan duhet me na ndihmue, të jetë i njejtë në 2 sezonat fillon në ora 7 dhe mbaron në ora 22.

Kryesuesja – Ju lutem z.Ajeti mund ta përfundosh

Ajet Berisha – Mendoj se do të ndihmoj.

Kryesuesja – Për me ndihmue është mirë me marrë pjesë në debate publike, që nuk di pse nuk keni marrë pjesë në debat publik dhe me punue me Komisionin.

Ajet Berisha – Nuk ka më mirë se me ndihmue nga këtu, ndërsa për debate publike është Komisioni. Mendoj se në këtë drejtim është dashtë me pritë dhe me u konsultue drejtori dhe Komisioni përgjegjës me barnatoret që funksionojnë në Komunën e Obiliqit, ndoshta kishte me qenë mirë për me i stimulue këto, që me nejtë kujdestar. Ndoshta, kishte me qenë mirë që të gjitha barnatoreve me ua bë që me punue deri në ora 20 dhe ajo që mbetet kujdestare pas orës 20 me pasë vullnetin me qendruë deri ne ora 7.

Abdyrrahman Krasniqi – Z. Ajet, te neni 10, është 7 24, në zonat rurale dhe 7 23 në zonat urbane dhe ky është dallimi që thatë se është përsëritë. Sa i përket bastoreve, kazinove pajtohem se duhet të hiqen sepse janë të ndaluara me ligj, por Komisioni ka punuar në këtë drejtim dhe ne i kemi dhënë sugjerimet tona gjatë gjithë kohës.

Kryesuesja – E hudhi në votim Draft Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve duke larguar nga neni 10, bastoret dhe kazinot.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe me 6 vota kundër e aprovuan Rregulloren nr.-I-36, të dt.25.02.2009, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

Sami Ahmeti – Ne zakonisht kur bëhet fjalë për Rregulloren për me dalë në debat publik, jemi gjithmonë dakord, por në këtë rast po shohim se është një tendencë posaqërisht pas zgjedhjeve lokale për hakmarrje ndaj zyrtarëve që punojnë në Komunën e Obiliqit. Ata që konsiderohen si kundërshtarë politikë, po maltretohen pa kurrfarë arsyeje nga mbikqyrësit e tyre.

Kryesuesja – Ju lutem në pikën të ndryshme mund të diskutoni për këtë çështje, ndërsa tani e kemi Draft Rregulloren për daljen në debat publik.

Sami Ahmeti – Pikërisht të Rregullorja është fjala.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 10 vota për dhe 6 vota kundër e aprovuan daljen në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për emërtim të rrugëve.

Enver Gashi – Ky Kuvend e ka caktue edhe Komisionin, ka kalue në KPF, e kemi adresue në Drejtori, Drejtoria e ka sjellë vendimin dhe ne jemi për sepse janë zbatuar të gjitha rregullat dhe procedurat që duhet të jenë për emërtimin e rrugëve.

Sami Ahmeti – Është e vërtetë që ky Kuvend e ka formuar Komisionin për tu marrë me këto punë dhe ne e dimë se edhe Kuvendi në fund i miraton listat, ose nuk i miraton. Te kjo kërkesë e DPUKP-së, nuk përfshihet puna e Komisionit, nuk ka ndonjë vlerësim të Komisionit, por është vetëm një vlerësim vetëm i drejtorit që i ka bërë copy-paste kërkesat e qytetarëve, të cilat i mirëkuptojmë. Mirëpo, nuk ka asnjë arsyetim që tregon për çka, sa banorë jetojnë në atë fushë, ku është kjo rrugë dhe cilat janë specifikat e atyre rrugëve. Si rrjedhojë për të respektue të drejtat e secilit, ne nuk do të marrim pjesë në votim.

Ajet Berisha – Ky Kuvend ka formuar një Komision që është dashur të mbajë debate me qytetarë dhe nuk e di se kush është në Komision, që më vjen keq sepse Kryetari i Komisionit është dashur me dalë dhe me përfaqësue punën që e ka bërë në terren. Po ashtu, është dashur me sjellë procesverbalin nga ato takime se si janë marrë vesh. E para, do të thotë është një mungesë, që Komisioni ose s'ka bërë asnjë punë, ose nuk e ka pasqyruë punën e vet dhe ne nuk kemi asnjë procesverbal nga këto takime. E dyta, drejtori me rekomandimet e tij në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe unë qytetarët i falenderoj sepse kërkesat e tyre i kam parë dhe i kam lexue, janë tregue shumë të sinqertë. Ata nuk i kanë hiperpolizue propozimet e tyre përveç dikund dikund ku janë mbështjellë hero dhe dëshmorë, që nuk është e familjes me caktue se kush është hero e kush dëshmorë brenda anëtarëve të familjes së tyre, sepse janë institucionbet që e përcaktojnë atë epitete të dëshmorit dhe heroit. Mendoj se pjesën tjetër qytetarët janë treguar tepër të sinqertë me veprimtaritë që i kanë krye për propozuesit për emër të rrugëve. E keqja është që drejtori dhe ky Kuvend duhet me zbatue fillimisht një vendim të këtij Kuvendi, që është një listë pritëse e rrugëve që e ka miratue ky Kuvend. Në rast se Komuna e Obiliqit në kohën kur janë miratue emërtimi i këtyre rrugëve i ka pasë 360 rrugë, dikund 70 emra kanë qenë rezervë që për çdo rrugë që hapet pavarësisht konsultimeve, ato do të jenë propozimet bazë, që drejtori këtë nuk e ka parasysh fare. E dyta, është tejet përulëse për neve me ardhë drejtori me këto rekomandime qysh na ka ardhë neve dhe i kisha lexue arsyetimet që i ka ofruë drejtori. Ndërsa, drejtori nuk është me ofruë arsyetim çka ka thënë familja, ose lagjja për me ia vënë emrin një rrugë, por ai duhet ti vërtetoj ato që janë thënë dhe me ardhë me letra mbështetëse. Thuhet nën 1, sipas kërkesës së palës ishte i përndjekur nga policia serbe, që nuk e ka konstaue këtë punë nën 2, sipas kërkesës së palës, gjithmonë kjo nuk hiqet shquhet si kundërshtar i regjimit jugosllav, do të thotë këtu konstatim s'ka,

por vetëm i përsëritë kërkesat e palëve, nën 3, ishte i përndjekur nga policia serbe për shkak të pikëpamjeve kundërshtuese që kishte ndaj regjimit dhe i burgosur në 47, a ka letra për këtë punë.

Kryesuesja – Faleminderit z.Berisha, koha juaj mbaroi. Ju po lexoni diçka që e kemi të gjithë dhe e dijmë.

Arben Berisha – Ju njoftoj se me dt.31.01.2022, kur e kemi marrë vendimin për Komisionin, e kam marrë edhe procesverbalin se e kam ditë se çka kanë me thënë. Ty z.Ajet, ty nuk të ra taman askund prej se është nisë mbledhja dhe e kam ditë që edhe këtu s'ka me të ra taman. Mirëpo, unë e kam marrë edhe procesverbalin kur e kemi formuar Komisionin. Unë kam thënë bazuar në praktikën e mëhershme, që me pasë edhe një Komision prej Kuvendit sepse është çështje shumë e ndijshme dhe këtë e dijmë prej praktikës se nuk është rasti i parë që i kemi lënë emrat e rrugëve, por janë shumë raste që iu kemi lënë edhe më heret. Edhe atëherë kam qenë shoqëruar i Komisionit se nuk kam qenë në Komision, bile në lagjen time kam marrë pjesë. Bazuar në ligje dhe Udhëzimet administrative, DPUKP-ja, në veçanti në zonat e Hades së Re, i propozon Kuvendit në konsultim me qytetarë. Ne nuk mundemi me ia imponu askujt se cilin emër me ia lënë asaj rruge sepse ka kaluar ajo kohë. Ne kemi dalë bashkë me Komisionin, por procedura për me shkue në Ministri, është se duhet me shkue me këto procedura. Do të thotë Drejtoria i propozon Kuvendit, Kuvendi merrë vendim, ose refuzon. Nuk është e vërtetë, se nuk kanë historiat, të gjitha kanë historiat dhe pse ai ia len emrin e babës së vet, ne nuk mund ti themi se ke me ia lënë të babës tim, sepse ligji thotë në konsultim me qytetarët. Ne e kemi listën e pritjes, por nuk po e dojnë sepse don me ia vënë emrin e një familjarit të vet, që ndoshta për neve ka pak vlera, por për atë ka vlera shumë. Tani, a është i përndjekur ne s'mundemi me konstatue dhe besoj se asnjëri prej juve s'mundemi me konstatue që mua më ka rrahë policia. Unë dola me shumë me arsyetue punën e Komisionit dhe të Drejtorisë.

Ajet Berisha – Mendoj se meritojnë edhe nënat tona, pse gjithë emrat e baballarëve dhe të vëllezërve dhe a ka me pasë Komuna e Obiliqit, rrugë të mjaftueshme për krejtë baballarët dhe nënat tona për me iu vënë emrat. Krite ka, rrugët janë të qytetarëve të Obiliqit dhe secili babë i joni, secila nënë e jona ka dhënë kontribut sipas këtij niveli të propozimeve. Të gjithë kanë qenë o të përndjekur, të gjithë kanë qenë të vuajtur për me mund me realizue ekzistencën tonë, përpjekje të hatashme kanë bërë për me jetue dhe me na rritë. Mirëpo, jo secili prind i joni meriton me pasë emrin në rrugë sepse ka krite. Unë nuk them se drejtori ka bërë keq proceduralisht sepse është përgjegjës, por thirrjen që e ka bërë, e ka jashtëzakonisht nën çmuese. Kërkesa e qytetarëve është e arsyeshme, ka krite për emërime dhe a ka zbatuar ndonjë kriter ky Komision, a do të kemi rrugë të mjaftueshme që secili qytetarë i joni që vdes me ia vënë emrin e tij rrugës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan kërkesën e DPUKP-së, për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesja – Ju njoftoj se disa kërkesa i kemi adresue te Drejtoritë përkatëse, por i lus Drejtoritë që pas shqyrtimit të kërkesave, ti adresojnë me rekomandime në Kuvend.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet plotësim ndryshimin e vendimit të Komitetit për komunitete, nr.-I-21, të dt.04.02.2022, ku ne vend të Katarina Adjancic nga subjekti politik Lista Serbe (LS) vjen Biljana Spasic, nga po i njejtij subjekt politik.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan Vendimin për Zëvendësimin e anëtares së Kuvendit komunal Katarina Adjancic, nga subjekti politik Lista serbe (LS) në Komitetin për komunitete me anëtares Biljana Spasic, e cila vjen sipas radhës nga po i njejtij subjekt politik.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-47, të dt.29.03.2022, për bartjen e mjeteve dhe vendimit nr.-I-48, të dt.29.03.2022, për rritjen e të hyrave vetanake 2021.

Zarife Behluli – Sqaron se te projekti hartimi i planit zhvillimor komunal te hartat zonale, te planifikimi urban dhe mjedisi në vlerë prej 50,734.73, ka qenë në projekt kapital në vitin 2021, ndërsa nuk ka qenë i buxhetuar në vitin 2021. Prandaj, kjo vlerë duhet të ndryshoj, të hiqet nga investimi kapital dhe të kalon në mallra dhe shërbime sepse parashihet se nuk i takon investimit kapital dhe është shërbim.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-47 të dt.29.03.2022, për bartjen e mjeteve buxhetore në vlerën prej 368,930.25 dhe vendimin nr.-I-48, të dt.29.03.2022, për tejkalimin e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2021.

Shaip Paloja – Unë e kam një kërkesë që është kryesisht për gjeneratat e reja dhe mendoj se krejtë mundin që ne e bëjmë, e bëjmë për gjeneratat e reja, e bëjmë edhe sot dhe në të ardhmen. Unë e kam një kërkesë nga shkollat e futbollit “Ardhmëria” dhe “Urbano” që veprojnë në Milloshevë dhe Raskovë. Kjo nuk është kërkesë me shkrim, por më janë drejtuar gojarisht. Te shkolla e futbollit “Ardhmëria” aty veprojnë disa gjenerata të futbollit duke filluar nga gjeneratat U9, U13, U15 dhe U17 dhe e kanë klubin e futbollit të femrave. Po ashtu, edhe “Urbano” e ka veprimtarinë njejtë sikurse ata. Edhe pse kur ata bëjnë veprimtari është pronë e Komunës, ajo fusha në Milloshevë, ata kishin një ofertë prej federatës së futbollit, që ajo fushë të shtrohet me një bari sintetik dhe të vendoset rrethoja dhe ndriçimi. Mirëpo, kusht i federatës është që rrethojën dhe ndriçimin me krye Komuna, ndërsa barin sintetik me vendosë Federata e futbollit. Gjithashtu, edhe në Raskovë më janë drejtue me një kërkesë për ndriçim të fushës dhe aty ishin të vendosur disa poqe për ndriçim të fushës, por nëse nuk gaboj janë kërkuar eventualisht edhe 2, ose 3 për me pasë ndriçim. Unë e di veprimtarinë e tyre se pak a shumë jam në ngjarje dhe jam në rrjedha të futbollit dhe besoni është kënaqësi me shku dhe me i pa ato shkolla të futbollit sa mirë punojnë. Është kenqësi sepse më shumë se qindra të rinjë largohen prej rrugëve jo të mira dhe merren me aktivitete sportive. Ata e pranojnë se Komuna iu ka dalë disa herë në ndihmë. Nëse, janë mundësitë unë po e përcjelli kërkesën e tyre dhe DKRS-ja, nëse ka buxhet mendoj se është interes i përgjithshëm me iu dalë në ndihmë.

Labinot Mirena – Duke parë kohëve të fundit rritjen e vazhdueshme të çmimeve, e si pasojë e tyre edhe rritjen e kostos së jetesës për qytetarët tonë, propozoj që ne si Kuvend komunal, të inicojmë një kërkesë që të iu sigurohet shujta ditore nxënësve si fillim i nivelit parashkollor si dhe klasëve prej 1-9. Kjo bëhet me qëllim që sado pak të iu sigurohet prindërve sigurimi i shujtave ditore për nxënësit dhe trajtimi e ndjenja e fëmijëve të barabartë me njëri tjetrin pasi që edhe ushqimi do të ishte i njejtë për të gjithë si dhe asnjë nxënës të mos mbetet i uritur gjatë orarit mësimor. Kërkoj që sa më parë të vazhdojmë me këtë proces pasi që edhe mundësitë buxhetore janë për një veprim të tillë. Uroj dhe shpresoj që të gjejmë një mirëkuptim dhe mbështetjen nga të gjithë të pranishmit sepse është një interes i përbashkët i të gjithëve.

Bajram Hashani – Unë e kam një kërkesë për kryesuesen se anëtarja e Komitetit për Politikë dhe Financa Linda Sadiku, do të shkarkohet nga ky Komitet, për arsye se gjithnjë është kundër vendimeve të shumicës apo të z.Komitetit për Politikë dhe Financa. Kërkesa e LDK-së, është që Linda Sadiku, të shkarkohet nga ky Komitet.

Pas propozimit, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-2, të dt.24.12.2021, i Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarin Bajram Hashani (LDK) në vend të Linda Sadikut, nga po i njejtë subjekt politik.

Valon Svirca – Pyei si është gjendja e subvencionimit të serave kur dihet se në kohë të zgjedhjeve është dalë një listë fituese e fermerëve të serave dhe dihet se tash koha e të mbjellurave besoj se ka kaluar.

Kryesuesja – Edhe z.Sami Ahmeti, ka bërë këtë kërkesë në KPF, drejtori i bujqësisë është në udhëtim jashtë vendit, por besoj se në seancën e radhës ai do ta sqaroj çështjen në fjalë.

Xhelal Krasniqi – Një kërkesë nga qytetarët është se Komuna jonë a ka një Rregullore që sanksionon ata që hudhin mbeturina jashtë vendit adekuat. Po ashtu, a ka Komuna një lokacion për hedhjen e mbeturinave të rënda. Nëse, ka Rregullore pse nuk po gjobiten shkelësit e kësaj Rregulloreje, kur pranë çdo lumi nëse dalim, ose nëpër vende të caktuara ka deponi të egra ilegale. Së bashku me këta qytetarë thanë se Komuna e Prishtinës, këtë gjë e ka rregullue dhe Komuna e Vushtrisë, prandaj këto 2 Komuna le të merren si model për këtë çështje.

Ibush Mjekiqi – I përgjegjem z.Shaip Paloja, se ne e kemi në planet tona rregullimin e këtyre 2 fushave, prandaj pasi që janë në hartim të projekteve, ne kemi pasur takim me federatën e futbollit, që i kanë pasë zgjedhjet tashmë në këtë kohë. Mirëpo, takimi ka ndodhë edhe pas zgjedhjeve që i kanë pasë në kuadër të

federatës, kështu që jemi në kontakt dhe mendoj se brenda 1 viti, ose 1 viti e gjysmë këto fusha do të jenë të rregulluara. Ishte kërkesa e z.Xhelal, dhe mund të them se ne e kemi një Rregullore për menaxhimin e mbeturinave, që është caktuar vendi për mbetjet inerte, apo të rënda, materialet ndërtimore që janë në deponinë e Mirashit. Sido që të jetë i takon Drejtorisë përkatëse, të merret me gjoba, por ka pasë edhe gjoba në këtë drejtim. Sa i përket serave, ishte një marrëveshje për subvencionim respektivisht furnizim me sera të fermerëve të Komunës tonë dhe kjo është përfundue në masën 50 %, ndërsa presim edhe 50 % të realizohen serat tjera, për përfituesit që janë në listë. Kërkesën e z.Labinot Mirena, do ta shqyrtojmë dhe tani për tani nuk kam përgjegje për këtë kërkesë.

Blerona Mehmetaj Shabani – Përgjegjet për subvencionimin e lehonave se siç e dijmë në fundvit mbyllet sistemi dhe lehonat të cilat kanë mbetë në vitin 2022, janë bartë në vitin 2022. Është bërë pagesa për lehonat për vitin 2022 dhe një pjesë për vitin 2022, ndërsa lehonat tjera janë në proces.Nëse, ka dikush që ka paraqitë kërkesë për mospagesë lirisht le të drejtohet te Drejtoria jonë.Vlen të theksohet se ka edhe prej atyre lehonave të cilat për të njejtën lindje bëjnë 2 herë kërkesë për subvencionim dhe kjo nuk lejohet sepse për një lindje subvencionohet vetëm një herë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:27'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

